


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6196
E hënë, 21 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €

Bëhet thirrje që
komunat ta ndalojnë
shitjen dhe përdorimin e
mjeteve piroteknike



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", HAXHI SHALA | FAQE 4-5

EDHE PDK-së I KONVENON HARADINAJ PRESIDENT



Deputeti nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Haxhi Shala, ka thënë se lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, është vonuar për thirrjen e tryezës për të diskutuar për zgjedhjen e presidentit. Në këtë intervistë dhënë

për gazetën "Epoka e re", Shala ka thënë se AAK-ja vazhdon ta mbrojë qëndrimin se Ramush Haradinaj është kandidati më i duhur për president në këtë kohë. Shala ka thënë se kandidatura e Haradinajt për president i konvenon edhe Partisë Demokratike

të Kosovës (PDK). Deputeti i AAK-së thotë se nëse nuk ka pajtueshmëri që Haradinaj të jetë president, atëherë vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, edhe pse thotë se Kosova nuk e ka luksin për zgjedhje të reja

OPINION

PSE MURAT JASHARI,
NIPI I BACËS ADEM JASHARI,
DUHET TË JETË PRESIDENT
I RI KOSOVËS | F. 11

Nga Bedri
ISLAMI



AKTUALE

PËRPLASJET E HOTIT DHE
VUÇIQIT NË DISTANCË | F. 5

SPITALI I GJAKOVËS SË SHPEJTI
BËHET ME REZERVUAR PËR
FURNIZIM ME OKSIGJEN TË
LËNGSHËM | F. 6



EKONOMI



KOMPANITË QË NUK
RAPORTUAN HUMBJE
NË PANDEMI | F. 9

RUKIOI KËRKON MASA
SHITESË NË TRE VJETËT
E ARDHSHËM | F. 8

SPORT

PRISHTINA, PAQE ME DRITËN | F. 11

COVID-19, HOTI: QYTETARËT TË KENË KUJDES MAKSIMAL NË JAVËT E ARDHSHME

| FAQE 3


Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se qytetarët duhet të kenë kujdes maksimal në javët e ardhshme pasi, sipas tij, virusi Covid-19 mund të përhapet në prag të festave të fundvitit.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit tetë pacientë kanë vdekur dhe janë regjistruar 223 raste të reja me Covid-19



MUSLIU: QEVERIA E LODHTË HOTI DËSHTOI TA MENAXHOJË SIGURINË

| FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni prezanton ekipin për mjedis, sinjalizon se ndryshimet klimatike do të jenë prioritet



UASHINGTON, 20 DHJETOR - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka prezantuar ekipin për mjedis dhe energji, duke thënë se ata do të jenë pjesë e "planit ambicioz për ta adresuar kërcënimin ekzistencial të kohës sonë, ndryshimet klimatike".

Duke folur në një ngjarje të organizuar në Uillmington të Delauerit, Biden tha se ndryshimet klimatike dhe çështjet mjedisore do të jenë pjesë qendrore e administratës së tij. "Jemi në krizë. Njëjtë sikurse që duhet të jemi të bashkuar për t'iu përgjigjur Covid-19, ne duhet të jemi të

bashkuar për t'iu përgjigjur ndryshimit të klimës", tha ai.

Bideni pritet që të ketë një qasje ndryshe nga presidenti Donald Trump lidhur me këtë çështje. Trumpi e tërhoqi ShBA-në nga Marrëveshja e Parisit për klimën dhe, po ashtu, ka hequr dorë nga një sërë rregulloresh mjedisore.

Bideni ka thënë se ai planifikon që ta kthejë ShBA-në në Marrëveshjen e Parisit.

Luftimi i ndryshimeve klimatike dhe përmirësimi i mjedisit priten të jenë pjesë e planit të rimëkëmbjes ekonomike të Bidenit.

Gjatë fjalimit të tij në Uillmington, Bideni përsëriti

premtimin e tij se ekipi i tij do ta pasqyrojë diversitetin e Shteteve të Bashkuara. "Tashmë ka më shumë njerëz me ngjyrë në kabinetin tonë se në çdo kabinet tjetër. Po ashtu ka më shumë gra se kurrë më parë", tha Bideni.

Në mesin e të nominuarve për ekipin për mjedisin, Bideni ka zgjedhur Deb Haaland nga Nju Meksiko, që pritet ta udhëheqë Departamentin e Brendshëm, departament ky që është përgjegjës për menaxhimin e tokës dhe burimeve federale.

Nëse konfirmohet nga Senati, Haaland do të bëjë amerikanë e parë autoktone që do ta udhëhiqte Departamentin e Brendshëm.

Gjermania shënon rënie të dëbimeve në vitin 2020

BERLIN, 20 DHJETOR - Rastet e dëbimeve nga Gjermania kanë rënë ndjeshëm më 2020 dhe kjo pjesërisht i atribuohet pandemisë së koronavirusit. Nga janari deri në fund të tetorit, 8,802 persona janë dëbuar nga Gjermania, tha Volkmar Vogel nga Ministria e Brendshme gjermane.

Nëse bëhet krahasimi me vitin 2019, ky numër është shumë i vogël, pasi vitin e kaluar nga Gjermania ishin dëbuar 22 097 persona,



raporton Dpa.

Sipas raportit të Ministrisë së Brendshme, numri më i lartë i personave të dëbuar janë nga Shqipëria (733 persona), pasuar nga Gjeorgjia (711 persona), Franca (369 persona), Serbia (608 persona) dhe Moldavia (525 persona). Për shkak të pandemisë ka pasur shumë pak fluturime. Disa nga vendet e origjinës të personave të dëbuar ndonjëherë kanë refuzuar që

t'i pranojnë shtetasit e tyre, duke cituar arsyet e mbrojtjes nga infektimet me koronavirus.

Ndërkaq, numri i largimit vullnetar nga Gjermania, e që këto udhëtime janë financuar nga qeveria federale gjermane dhe qeveritë shtetërore, po ashtu është më i ulët më 2020. Sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme, deri në tetor 4 319 persona janë larguar në mënyrë vullnetare nga Gjermania.

Bullgaria planifikon ta nisë vaksinimin kundër Covid-19 në fund të dhjetorit

SOFJE, 20 DHJETOR - Bullgaria planifikon që ta nisë vaksinimin kundër Covid-19 më 27 dhjetor. Vaksinat do të administrohen në tri qytetet kryesore bullgare, ka njoftuar shefi i Inspektoratit Shëndetësor, Angel Kunchev.

Së bashku me shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian, Bullgaria po pret që Agjencia Mjekësore Evropiane (EMA), ta miratojë vaksinën kundër koronavirusit të prodhuar nga kompanitë "Pfizer" dhe "BioNTech". "EMA

pritet që për këtë gjë të njoftojë më 21 dhjetor", raporton "Reuters". Kunchev tha se kamionë me doza të vaksinës pritet të vijnë nga Belgjika dhe t'iu shpërndahen të gjitha vendeve anëtare të BE-së më 24 dhjetor.

Ai ka thënë se pret që vaksinat në Bullgari të arrijnë në orët e vona të 25 dhjetorit apo më 26 dhjetor. "Ne jemi të përgatitur dhe do ta nisim vaksinimin një ditë më vonë, më 26 dhjetor, në spitalet e qytetit të Sofjes, Varnës dhe Burgasit", tha ai.

Administrimi i vaksinave kundër Covidit tashmë ka nisur në Mbretëri të Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Kanada.

Bullgaria do ta marrë kontingentin e parë të vaksinave prej 10 000 vaksinash dhe Kunchev tha se pret që edhe 57 000 vakcina të tjera të arrijnë në janar, ndërkaq në muajt në vijim do të vijnë edhe të tjera. Të dielën, më 20 dhjetor, Bullgaria raportoi për 1 002 raste të reja me Covid. Numri i



përgjithshëm i rasteve në këtë shtet ka arritur në 191 029,

ndërkaq 6 551 pacientë kanë vdekur.

Tetë të vrarë nga një sulm me bombë në Kabul



KABUL, 20 DHJETOR - Ministria e Brendshme e Afganistanit ka njoftuar se një makinë bombë ka vrarë të paktën tetë persona dhe ka plagosur dhjetëra të tjerë në Kabul.

Shpërthimi që ndodhi më 20 dhjetor kishte për cak një konvojë ku udhëtonte Khan Mohammad Wardak, pjesëtar i parlamentit, i cili u plagos në këtë sulm. "Terroristët kanë

kryer një sulm terrorist në qytetin e Kabulit. Fatkeqësisht, tetë qytetarë tanë janë vrarë dhe mbi 15 të tjerë janë plagosur", ka njoftuar zëdhënësi i

Ministrisë së Brendshme, Tariq Arian. Asnjë grup deri më tani nuk e ka marrë përgjegjësinë për sulmin edhe pse zyrtarët kanë fajësuar talibanët.

Covid-19, Hoti: Qytetarët të kenë kujdes maksimal në javët e ardhshme



Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se qytetarët duhet të kenë kujdes maksimal në javët e ardhshme pasi, sipas tij, virusi Covid-19 mund të përhapet në prag të festave të fundvitit. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit tetë pacientë kanë vdekur dhe janë regjistruar 223 raste të reja me Covid-19

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka njoftuar për masat e reja kufizuese që kanë për qëllim parandalimin e përhapjes së Covidit. Ai ka thënë se kanë bërë analizën e ndikimit të masave anti-Covid që i kanë marrë më 11 nëntor, të cilat, sipas tij, kanë dhënë rezultat. "Kategorizimi i komunave iu ka ndihmuar qytetarëve dhe shtabeve lokale për ta menaxhuar situatën dhe për ndërmarrjen e veprimeve për ta përmirësuar kategorizimin e komunës së tyre", është shprehur Hoti.

Ai ka shtuar se në prag të festave të fundvitit jemi para një rreziku të përhapjes së infeksionit për shkak të lëvizjeve të mëdha të qytetarëve që ndodhin në kohë festash. "Të gjithë po e shohim trendin në rritje në BE dhe rajon, ku disa vende janë mbyllur plotësisht. Kjo nënkupton se për disa javë edhe te ne rastet do të rriten. Prandaj, me propozim të IKShPK-së dhe në konsultim të

gjerë, ministri i Shëndetësisë do t'i propozojë së shpejti masat shtesë. Masat do të ndërmerren në konsultim edhe me komunat, shoqatat e bizneseve, grupet e ndryshme, si dhe partnerët dhe organizatat ndërkombëtare që po na ndihmojnë për menaxhimin e situatës. Nga muajt e verës ne jemi duke kryer konsultime javore me partnerët dhe organizatat relevante ndërkombëtare. Çdo të premte e vlerësojmë situatën dhe marrim rekomandime nga ta", ka treguar Hoti.

Kryeministri ka bërë me dije për masat e reja të ndërmarra në disa institucione. "Të gjitha institucionet publike të ndalojnë çfarëdo organizimi për fundvit që i bëjnë zakonisht për punonjësit e institucioneve. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme do ta përgatitin urdhëresën për këtë qëllim. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkërendim me komunat, t'i urdhërojnë menjëherë të gjitha shkollat të ndalojnë çfarëdo organizimi apo

ekskursionin të nxënësve apo arsimtarëve. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është përgjegjëse për ngjarjet sportive dhe kulturore të cilat mund të zhvillohen vetëm sipas udhëzimeve të parapara në manualin për mbrojtje nga Covid-19. Një komision do të funksionojë brenda ministrisë për miratimin e ngjarjeve të tilla. Gjithashtu, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, së bashku me AVUK-un, ta inspektojnë zbatimin e masave me mbështetje të policisë", ka thënë Hoti.

Ai ka theksuar se Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës përmes ambasadave do t'i njoftojë bashkatdhetarët për masat që janë në fuqi në Kosovë si dhe për kërkesat e vendeve përkatëse kur bashkatdhetarët të kthehen në vendet ku punojnë dhe jetojnë. Sipas Hotit, Ministria e Shëndetësisë duhet ta mbajë konferencën e rregullt për media për t'i informuar qytetarët për gjendjen dhe për masat që duhen respektuar, në veçanti për

masat që do të ndërmerren për fundvit. "Në anën tjetër, ministri Zemaj po punon shumë për sigurimin e vaksinës me partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilëve u jemi borxhli përgjithmonë për mbështetjen në këtë kohë të vështirë. Unë i ftoj të gjithë qytetarët të kenë kujdes maksimal në javët në vijim, kur virusi mund të përhapet pasivisht", ka deklaruar kryeministri Hoti.

Tetë të vdekur dhe 223 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit tetë pacientë kanë vdekur dhe janë regjistruar 223 raste të reja me Covid-19. "Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë dy raste (66, 63 vjeç), Drenas një rast (69 vjeç), Istog një rast (74 vjeç), Kamenicë një rast (78 vjeç), Mitrovicë një rast (66 vjeç), Obiliq një rast (70 vjeç) dhe Suharekë një rast (65

vjeç)", thuhet në njoftimin e IKShPK-së.

Rastet e reja dalin pas testimit të 1 001 mostrave. Siç njofton IKShPK-ja, gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 342 pacientë.

Që prej 13 marsit e deri më 20 dhjetor në Kosovë janë regjistruar 48 905 raste me Covid-19. Prej tyre, 1 256 pacientë kanë vdekur dhe 36 568 të tjerë kanë mposhtur Covidin. Raste aktive, ndërkaq, vazhdojnë të jenë 11 081.

MSh-ja sqaron masat kundër Covid-19 për diasporën

Ministria e Shëndetësisë ka sqaruar se të gjithë qytetarët e Kosovës, që vijnë nga vendet perëndimore, nuk duhet të paraqesin test negativ me metodën PCR me të hyrë në territorin e Kosovës. Përmes një njoftimi për media, MSh-ja ka njoftuar se testi negativ PCR kërkohet vetëm për ata që nuk kanë vendbanim në Kosovë dhe "të cilët vijnë nga vendet e ranguar me rrezik të lartë", sipas klasifikimit që bën Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjes (ECDC). "Qytetarët të cilët nuk kanë vendbanim në Kosovë, e që me rastin e hyrjes në Kosovë e kanë testin e bërë në vendin prej nga vijnë, ndërsa ata që nuk e kanë këtë vetizolohen për shtatë ditë si masë kujdesi dhe në rast se manifestojnë shenja të pranishme së virusit, e kanë mundësinë që, sipas indikacioneve mjekësore, të testohen në institucione publike sikurse çdo qytetar tjetër i Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Ditët e fundit shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë vendit po vijnë drejt Kosovës për t'i kaluar festat e fundvitit. Kjo ka bërë që në kufijtë e vendeve të Ballkanit Perëndimor të krijohen kolona të gjata me vetura. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës në Qeverinë e Kosovës, të shtunën, më 19 dhjetor, ka njoftuar se pritet në kufijtë e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë deri në dhjetë orë.

Gjobiten 677 qytetarë për mosrespektim të masave kundër pandemisë

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Policia e Kosovës njofton se gjatë 24 orëve të fundit ka shqiptuar gjoba ndaj 677 qytetarëve të cilët nuk kanë respektuar Ligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19.

"Tiketa të shqiptuara në bazë të Ligjit Covid-19 janë 677",

thuhet në raportin e Policisë së Kosovës, në të cilin nuk specifikohen shkeljet që i janë bërë këtij ligji.

Ligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 është miratuar në muajin gusht nga Kuvendi i Kosovës. Gjobat për mosrespektim të këtij ligji fillojnë nga 35 deri në

2 000 euro, varësisht nga shkeljet. Masat aktuale kundër Covidit që janë në fuqi janë të ndara në komuna, të përcaktuara varësisht nga numri i të infektuarve.

Në disa komuna ka edhe kufizim të lëvizjes dhe mbyllje të aktivitetit ekonomik nga ora 19:00 deri në orën 5:00.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, HAXHI SHALA

EDHE PDK-së I KONVENON HARADINAJ PRESIDENT

Deputeti nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Haxhi Shala, ka thënë se lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, është vonuar për thirrjen e tryezës për të diskutuar për zgjedhjen e presidentit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Shala ka thënë se AAK-ja vazhdon ta mbrojë qëndrimin se Ramush Haradinaj është kandidati më i duhur për president në këtë kohë. Shala ka thënë se kandidatura e Haradinajt për president i konvenon edhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Deputeti i AAK-së thotë se nëse nuk ka pajtueshmëri që Haradinaj të jetë president, atëherë vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, edhe pse thotë se Kosova nuk e ka luksin për zgjedhje të reja

“Besoj se do të arrijmë një marrëveshje me PDK-në sepse edhe PDK-së i konvenon që Haradinaj të jetë president. Situata që është krijuar pas arrestimit të Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi, kandidat më adekuat se Haradinaj për president të shtetit, nuk ka. Pra, lideri ynë duhet të jetë në një pozitë të nivelit të lartë në këtë situatë në të cilën ndodhet vendi”, është shprehur ai.

Deputeti Shala në këtë intervistë ka folur edhe për Gjykatën Speciale. Ai u ka bërë thirrje institucioneve të vendit që të jenë më syçelë kur është në pyetje përkrahje për çlirimtarët të cilët ndodhën në Hagë. “Institucionet tona duhet ta mbrojnë UÇK-në sepse atje është Kosova dhe UÇK-ja, jo individët. Atje po dënohet UÇK-ja. Institucionet e Kosovës duhet të jenë më syçelura, më të hapura dhe më transparente për t’u dalë në ndihmë

çlirimtarëve”, ka deklaruar Haxhi Shala.

“Epoka e re”: LDK-ja ka paralajmëruar mbajtjen e një tryeze për të diskutuar rreth zgjedhjes së presidentit të ri, por një tryezë e tillë ende nuk është mbajtur. Si AAK keni ndonjë informatë se çfarë po ndodh?

Shala: Nuk kam ndonjë informacion përpos që janë deklaruar zyrtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës në media, se do të ndodhë një tryezë e partive politike për zgjedhjen e presidentit. Një iniciativë e llojit të tillë i takon LDK-së sepse është bartëse e koalicionit qeverisës dhe duhet sa më shpejt të vendoset për kandidatin për president. Mendoj se Isa Mustafa, si lider i LDK-së, është vonuar në këtë drejtim sepse është dashur t’i thërrasë partnerët e koalicionit për të diskutuar me ta dhe

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Deputeti nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Haxhi Shala, ka bërë me dije se kjo parti nuk ka ndryshuar qëndrim sa i përket kandidatit për president të ri të vendit. Ai thotë se AAK-ja mbështet kandidaturën e liderit të saj për president, Ramush Haradinaj.

“Ne si AAK mendojmë se në këtë kohë Haradinaj është personi më adekuat në këtë kohë për president”, ka thënë Shala në një intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”.

Ai ka thënë se nëse një gjë e tillë nuk ndodh, rrugë tjetër mbesin zgjedhjet. “Sipas mendimit tim, nuk është momenti që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme, por nëse partitë politike nuk gjejnë një zgjidhje

për ta mbështetur Haradinaj për president, atëherë nuk kemi rrugë tjetër, duhet të shkojmë në zgjedhje”, ka thënë ai.

Shala thotë se kandidatura e Haradinajt për president i konvenon edhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Ai shpreson se me këtë subjekt politik do të arrijnë një marrëveshje që ta përkrahin Haradinajn për president.



pastaj ta bëjë një ftesë për të gjitha partitë politike.

“Epoka e re”: Rreth zgjedhjes së presidentit ka deklarime edhe nga PDK-ja, se ky post i takon asaj dhe se ju si AAK keni propozuar Ramush Haradinaj për president. A ka ndryshuar qëndrimi i AAK-së?

Shala: Ne si AAK e kemi propozuar liderin e partisë për president. Ai e ka marrë mbështetjen e organeve të partisë. Ne qëndrojmë mbrapa propozimit të kandidatit tonë që ai të jetë presidenti i ardhshëm i vendit, pra Ramush Haradinaj.

“Epoka e re”: A prisni që nga kjo tryezë e partive politike të arrihet bashkim për kandidatin për president?

Shala: Shpresoj se po. AAK-ja është partia e dytë më e madhe brenda koalicionit qeverisës. Tashmë LDK-ja i ka dy pozita të nivelit të lartë të cilat i udhëheq, atë të kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit, ndërkaq posti i presidentit i takon AAK-së.

“Epoka e re”: Por pa votat e PDK-së nuk do të mund ta zgjedhni presidentin?

Shala: Besoj se do të arrijmë një marrëveshje me PDK-në sepse edhe PDK-së i konvenon që Haradinaj të jetë president. Situata që është krijuar pas arrestimit të Thaçi, Veseli,

Krasniqi dhe Selimi, kandidat më adekuat se Haradinaj për president të shtetit, nuk ka. Pra, lideri ynë duhet të jetë në një pozitë të nivelit të lartë në këtë situatë në të cilën ndodhet vendi.

“Epoka e re”: Vetëm për këtë arsye mendoni se PDK-ja duhet ta votojë Haradinajn për president pa marrë hise në qeveri?

Shala: Nuk do të thotë se duhet ta mbështetë por, së paku, të jetë e pranishme në sallë, nëse jo atëherë vendi shkon drejt zgjedhjeve të reja. Të gjitha partitë politike duhet të mendojnë mirë nëse Kosova e ka luksin të shkojë në zgjedhje të reja në këtë kohë, pa i mbushur ende një vit e gjysmë kjo qeveri.

“Epoka e re”: A duhet të shkojë vendi në zgjedhje të reja?

Shala: Sipas mendimit tim, nuk është koha që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme, por nëse partitë politike nuk gjejnë një zgjidhje për ta mbështetur Haradinaj për president, atëherë nuk kemi rrugë tjetër, duhet të shkojmë në zgjedhje.

“Epoka e re”: A mund të konsiderohet kërcënim ky: ose Haradinaj president, ose zgjedhje të reja?

Shala: Nuk është kërcënim. Mund të zgjedhet dikush tjetër.

Është PDK-ja dhe Lëvizja Vetëvendosje. Por ne si AAK mendojmë se Haradinaj është personi më adekuat në këtë kohë për president të shtetit.

“Epoka e re”: Po supozojmë se Haradinaj nuk zgjedhet president, pasi në këtë pozitë mund të zgjedhet dikush tjetër, atëherë AAK-ja do të dalë nga koalicioni qeverisës?

Shala: AAK-ja ka Këshillin Drejtues dhe ai do të dalë me vendim për çdo situatë. Ne jemi në koalicion për ta qeverisur vendin. Të shohim pastaj.

“Epoka e re”: Si deputet dhe zyrtar i AAK-së, çfarë vlerësimi keni për punën e qeverisë pasi si parti jeni pjesë e saj?

Shala: Vetë situata e pandemisë ka krijuar një atmosferë pak më të vështirë të qeverisjes së vendit. Asnjë qeveri, cilado që të ishte, nuk do të mund të bënte diçka më shumë në këtë situatë. Pandemia e ka futur në krizë vendin. Kosova po shkon drejt një krize ekonomike. Si parti politike qoftë në pushtet apo opozitë duhet të jemi të kujdesshëm në çfarëdo vendimi. Të krijojmë konsensus për çfarëdo teme.

“Epoka e re”: Lideri juaj ka kërkuar lehtësim të masave anti-Covid për festat e fundvitit, kur disa vende

evropiane po i shtrëngojnë masat.

Shala: Duke marrë për bazë se bashkatdhetarët tanë janë duke ardhur për festa të fundvitit në vendlindje, kemi menduar që qeveria dhe IKShPK-ja do të duhej të bënin lehtësime në masa. Por, gjithmonë edhe ne si qytetarë duhet të jemi striktë për zbatimin e masave, siç është mbajtja e distancës fizike dhe bartja e maskave. Pra, të kemi një lehtësim të lëvizjes që bashkatdhetarët të kenë hapësirë që t'i vizitojnë të afërmit e tyre për aq sa janë në pushim.

“Epoka e re”: Kosova po përballet edhe me Gjykatën Speciale. A do të duhej që institucionet të jenë me të vëmendshme në përkrahje të ish-udhëheqësve të UÇK-së dhe ish-ushtarëve të UÇK-së të cilët po akuzohen nga kjo gjykatë?

Shala: Institucionet e Republikës së Kosovës duhet të bëjnë më shumë në mbështetje të çlirimtarëve, të atyre që tashmë janë arrestuar. Institucionet tona duhet ta mbrojnë UÇK-në, sepse atje është Kosova dhe UÇK-ja, jo individët. Atje po dënohet UÇK-ja. Institucionet e Kosovës duhet të jenë më syçelura, më të hapura dhe më transparente për t'i dalë në ndihmë UÇK-së.

Përplasjet e Hotit dhe të Vuçiqit në distancë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë përplasur në distancë rreth procesit të dialogut që po zhvillohet në Bruksel. Presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se deri në prill të vitit 2022 Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës, duke aluduar në përfundim të mandatit të tij si president. “Ne kemi shumë çështje të rëndësishme, por deri në prill të vitit 2022, kur ka zgjedhje, si për presidentin ashtu edhe për parlamentin, kjo nuk do të ndodhë. Pastaj le të vendosin votuesit”, citohet të ketë thënë Vuçiqi.

Pas kësaj deklarate ka reaguar kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i cili ka thënë se nëse nuk do të ketë njohje reciproke, nuk do të ketë as marrëveshje të pjesshme me Serbinë. Ai ka thënë se Kosova mbetet e përkushtuar që të gjitha çështjet e hapura me Serbinë të përmbyllen përmes dialogut, i

cili po zhvillohet në Bruksel, me ndërmjetësimin e BE-së. “Deklaratat se fqinji ynë verior nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës nuk i kontribuojnë dialogut. Dialogu ka rifilluar mbi parime të qarta për marrëveshje përfundimtare për normalizim të marrëdhënieve dhe njohje reciproke dhe nuk do të ketë marrëveshje të pjesshme. Nëse nuk do të ketë njohje reciproke, atëherë nuk do të ketë as marrëveshje. Kosova do ta vazhdojë rrugën drejt Bashkimit Evropian”, ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në “Facebook”.

Kryeministri Hoti dhe presidenti i Serbisë më 4 shtator të këtij viti kanë nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë, në prani të presidentit amerikan Donald Tramp, një marrëveshje për normalizim ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo marrëveshje nuk ka filluar së zbatuari ende, ndonëse pala e Kosovës është zotuar se ajo marrëveshje do të zbatohet.

Në fillim të dhjetorit Komisioni Evropian miratoi një strategji për agjendën e re të raporteve transatlantike, më saktësisht



raporteve mes Bashkimit Evropian dhe ShBA. Në këtë agjendë strategjike, Komisioni Evropian përmend edhe nevojën që BE-ja dhe ShBA-ja të vazhdojnë bashkëpunimin edhe në Ballkanin Perëndimor, me theks të veçantë në dialogun Kosovë - Serbi.

“Evropa i ka dhënë Ballkanit Perëndimor perspektivë të anëtarësimit në BE. Vazhdimi i partneritetit mes BE-së dhe ShBA-së dhe koordinimi i afërt në Ballkanin Perëndimor është thelbësor, posaçërisht në dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës. Ne duhet të

punojmë së bashku për ta mbështetur pajtimin, ta përmirësojmë qeverisjen dhe t'i shtyjmë përpara reformat kyçe”, thuhet në tekstin e strategjisë së Komisionit Evropian për raportet në mes të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi.

Spitali i Gjakovës së shpejti bëhet me rezervuar për furnizim me oksigjen të lëngshëm

GJAKOVË, 20 DHJETOR (ER) - Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), dr. Valbon Krasniqi, i shoqëruar nga ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, kanë vizituar të dielën spitalin e përgjithshëm në Gjakovë. Gjatë takimeve në këtë spital janë njoftuar për punën që po bëhet në përgjithësi në këtë spital, me theks të veçantë për menaxhimin e pandemisë së Covid-19. Drejtori Krasniqi ka falënderuar menaxhmentin e spitalit dhe të gjithë punonjësit shëndetësor për punën, profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar për trajtimin e pacientëve të

dyshuar dhe konfirmuar me Covid-19, por edhe sëmundjeve të tjera. Gjatë vizitës u inspektuan hapësirat në të cilat po punohet për vendosjen e rezervuarit për furnizim me oksigjen të lëngshëm në këtë spital. Bazuar në dinamikën e punimeve, ky spital pritet që së shpejti, pas investimeve nga ShSKUK-ja, për herë të parë ta ketë rezervuarin për furnizim me oksigjen të lëngshëm. Drejtori Krasniqi dhe ministri Zemaj ofruan përkrahje në kërkesat që ka ky spital. Para disa ditësh, Spitali i Gjakovës ishte pajisur për herë të parë me një aparat modern të CT, donacion nga Ambasada Amerikane.



Konstituohet Këshilli Nismëtar i nëndegës së PDK-së në Gjenevë



PRISHTINË, DHJETOR (ER) - Në praninë e drejtorit të Departamentit për Diasporë të PDK-së, Elmi Reçica, zëvendës-drejtorit të këtij departamenti, Arben Gecaj dhe kryetarit të Këshillit Nismëtar, Mujë Haziri, është mbajtur takimi i Këshillit Nismëtar për nëndegën e PDK-së në Gjenevë. "Kontributi i diasporës është i njohur dhe i sprovuar në të gjitha etapat kohore, në të cilat ka kaluar vendi. Këtë kontribut e kemi parë dhe ndier edhe në kohën e

pandemisë", ka thënë Elmi Reçica në fjalën e tij para të pranishmëve. Reçica në vazhdim foli edhe për rolin e veçantë të Diasporës, aktualitetin politik nëpër të cilin po kalon vendi, Gjykatën Speciale dhe ngërçin institucional. "Në bankën e të akuzuarve në Gjykatën Speciale nuk ka individë të akuzuar. Aty po gjykohej Kosova. Përmes kësaj gjykate, po tentohet që Kosova të paraqitet si shtet i dështuar", ka thënë Reçica.

Në vazhdim, ai tha se duhet të ndahet interesi shtetëror nga politika e popullizmit. "Qeverisja e udhëhequr nga PDK-ja pati filluar me buxhet prej 600 milionë eurosh, ndërsa e përfundoi qeverisjen me një buxhet prej 2.3 miliardë eurosh. Gjatë kësaj kohe ka pasur edhe rritje të pagave për të gjithë të punësuarit në sektorin publik", ka deklaruar Reçica. Rreth përfshirjes së diasporës, Reçica ka premtuar se PDK-ja do të angazhohet që diaspora

t'i ketë përfaqësuesit e vet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. "Vizioni i Departamentit për Diasporë të PDK-së është që diaspora në vazhdimësi të jetë e informuar dhe e përgatitur që të veprojë së pari për të mirën e Kosovës, të mirën e vetë dhe të PDK-së. Misioni i saj derivon nga mundësia e shfrytëzimit të potencialit të diasporës për zhvillimin e vendit, qoftë përmes resurseve humane apo të kapitalit", ka thënë Reçica. Udhëheqësi i Këshillit

Nismëtar për nëndegën e Gjenevës, Mujë Hajrizi, pasi falënderoi veprimtarët e vjetër të PDK-së në Zvicër, të cilët tha se me veprimtarinë e tyre me dekada kontribuuan për lirinë dhe shtetndërtimin. "Manipulimi me opinionin në diasporë, për të vërtetën e Kosovës, na ka obliguar që bashkë me të gjithë juve, të riorganizohemi për ta paraqitur të vërtetën ashtu siç edhe është", është shprehur ai. Ndërsa zëvendës-drejtori i Departamentit për Diasporë, Arben Gecaj, në fjalën e tij para të pranishmëve foli për historikun e PDK-së në diasporë. Në pjesën e dytë të takimit, Reçica bashkëbisedoi me të pranishmit rreth aktualitetit politik. Këshilli Nismëtar u pajtua që shpejt ta fillojnë punën për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor për nëndegën e Gjenevës. Me vendim të kryesisë qendrore të PDK-së, është themeluar Departamenti për Çështje të Diasporës dhe i cili ka filluar aktivitetet për riorganizimin e PDK-së në të gjithë diasporën.

Dimri fillon sot, në fundjavë reshjet e borës

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Sot (e hënë) në orën 11:02 minuta fillon stina e dimrit astronomik. Edhe pse gjatë ndërrimit të stinëve shpeshherë kemi çrregullime në troposferë, një gjë e tillë nuk parashihet të ndodhë deri në fundjavë. Sipas Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, gjatë javës së ardhshme do të mbajë mot i vranët dhe me intervale kohore

me diell. Sipas Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, në fundjavë pritet të ketë kushte të tjera meteorologjike, vranësira të dendura të cilat parashihen të sjellin reshje bore. Kjo situatë e krijuar do të ndikojë në rënien e temperaturave minimale deri -6, -7 gradë celsius. Sa iu përket

temperaturave maksimale, ato vazhdojnë të mbeten mbi vlerat e normales për pesë ditë e ardhshme. Minimalet do të lëvizin ndërmjet -2 deri 1 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 5-10 gradë celsius. Do të fryjë erë nga jugperëndimi dhe veriperëndimi me shpejtësi 1-8 m/s.



Musliu: Qeveria e lodhtë Hoti dështoi ta menaxhojë sigurinë

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, ka kritikuar të dielën qeverinë Hoti për dështimin e saj në sigurinë e vendit dhe të qytetarëve. Deputetja Musliu ka thënë se kjo paaftësi ka bërë që situata të bie në duar të gangsterëve dhe grabitësve në vend. “PDK-ja konsideron se kjo qeveri e lodhtë është e paaftë ta menaxhojë këtë fushë”, ka thënë deputetja Musliu



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, ka mbajtur të dielën një konferencë për media. Në një konferencë për media, deputetja Musliu ka kritikuar qeverinë Hoti për dështimin e saj në sigurinë e vendit dhe të qytetarëve. Deputetja Musliu ka thënë se kjo paaftësi ka bërë që situata të bie në duar të gangsterëve dhe grabitësve në vend. “Sot ju kemi ftuar për të adresuar një çështje e cila ditët e fundit ka marrë përmasa shqetësuese. Bëhet fjalë për sigurinë e vendit dhe të qytetarëve të Kosovës, vjedhjet, grabitjet, plaçkitjet, sulmet me armë që po ndodhin gjithandej Kosovës, e me theks të shtuar në Prishtinë. PDK-ja po i ndjek me shqetësim zhvillimet e fundit në vend dhe e konsideron të

papranueshme këtë situatë të rrezikshme. Kjo është situatë me tendencë përkeqësimi të mëtejshëm të sigurisë në vend dhe e bën përgjegjëse drejtpërdrejt qeverinë Hoti e cila ka qasje joserioze karshi situatës. Brenda tri ditëve u raportua për disa vjedhje e grabitje bankash e biznesesh, e deri edhe tek arkat humanitare të vendosura te bizneset e ndryshme dhe libraritë. Në këto akte u plagos një polic nga grabitësit dhe u rrezikuan dhjetëra qytetarë të Kosovës. Mos të flasim për frikën që po përhapet te qytetarët, veçanërisht dëmi që po u shkaktohet bizneseve çdo ditë”, ka thënë Musliu.

Ajo ka thënë se nëse vazhdon ky trend i përditshëm i sulmeve e vjedhjeve ndaj bankave e bizneseve të vendit, Kosova do të hyjë në një cikël të rrezikshëm të pasigurisë dhe të mbylljes të bizneseve. “Askush nuk do të

ketë interesim e as guxim të investojë më në Kosovë nëse nuk ka siguri për jetën e tij, pronën dhe pasurinë. Kjo qeveri e lodhtë dhe ky kryeministër anemik në dukje, e tepër arrogant në veprime, duhet menjëherë ta ndërpresë mentalitetin primitiv të përndjekjeve dhe të shkarkimeve pa kurrfarë kriteri. Nuk jemi në pozitë kur mund të


lejojmë që institucionet më të rëndësishme të vendit të mbeten pa udhëheqës dhe të degradohen shkajshmërisht. Shumë pozita udhëheqëse kanë mbetur ose vakante ose me ushtrues detyre, të cilët, siç dihet, janë të hendikepuar në kompetencat e tyre. PDK-ja konsideron se kjo qeveri e lodhtë është e paaftë për të menaxhuar me këtë fushë”, ka

thënë ajo.

Deputetja Musliu ka thënë se shkarkimi i zyrtarëve profesionistë nga udhëheqja e institucioneve të pavarura e kredibile, dhe mungesa e një plani se çfarë do të veprohet konkretisht në situata dhe rrethana të caktuara, ka krijuar vakum institucional dhe mungesë të autoritetit përkatës shtetëror.

Bëhet thirrje që komunat ta ndalojnë shitjen dhe përdorimin e mjeteve piroteknike

Njohësi i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), Tahir Ahmeti, ka thënë se në çdo fundvit në Kosovë dhjetëra qytetarë, më së shumti fëmijë dhe të mitur, përfundojnë në qendra emergjente shkaku i lëndimeve të marra nga përdorimi joadekuat i mjeteve piroteknike. Ai u ka bërë thirrje komunave ta ndalojnë shitjen dhe përdorimin e mjeteve piroteknike



EPOKA
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka thënë se komunat duhet ta ndalojnë shitjen dhe përdorimin e mjeteve piroteknike gjatë festave të fundvitit. Ai ka thënë se në çdo fundvit në Kosovë dhjetëra qytetarë, më së shumti fëmijë dhe të mitur, përfundojnë në qendra emergjente shkaku i lëndimeve të marra nga

përdorimi joadekuat i mjeteve piroteknike. “Tani kur jemi në një situatë mjaft të vështirë, duke u ballafaquar me pandeminë botërore Covid-19, nuk do të duhej të shtohet edhe një vatër e re e rrezikimit të shëndetit të qytetarëve të vendit. Për ta rritur sigurinë, komunat (ato të cilat ende nuk kanë reaguuar), do të duhej që gjatë kohës së këtyre festave, ta ndalojnë me urdhëresë për një periudhë të caktuar kohore, përdorimin dhe shitjen e produkteve piroteknike, kurse gjithë ata që veprojnë në kundërshtim me urdhëresën,

duhet të gjobiten. Siguria e qytetarëve duhet të jetë primare”, ka thënë Ahmeti. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka nxjerr urdhëresë për ndalimin e

përdorimit të mjeteve piroteknike në vende të hapura publike, gjegjësisht në sheshe, rrugë e tregje. “Kushdo që vepron kundër kësaj urdhërese, gjobitet në shumën prej 100

eurosh. Për zbatimin e urdhëresës, e cila do të jetë në fuqi deri më 3 janar 2021, do të kujdeset Drejtoria e Inspeksionit”, ka bërë me dije kryetari Ahmeti.

Rukiqi kërkon masa shtesë në tre vjetët e ardhshëm



Prishtinë, 20 dhjetor - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se paratë e Fondit të Kursimeve Pensionale duhet të shpenzohen brenda vendit. Ai ka thënë se qytetarët e kanë mirëpritur këtë vendim pasi që pandemia Covid-19 ka shkaktuar shumë humbje të bizneseve. “Qytetarët e kanë

mirëpritur 10-përqindëshin e Trustit, por vetë shkalla e aplikimit dhe numri i aplikimeve na japin disa indikacione. Qytetarët janë në krizë se në kushte të tjera nuk do të ishin aq të etur për t’i tërhequr mjetet. Gjithashtu, ne e shohim që ka shumë nevoja bazike që qytetarët pritet t’i tërheqin nga 100 euro deri në 500

euro. Kjo tregon se mirëqenia në vend është e cenuar jo vetëm nga kjo krizë, por në përgjithësi nga zhvillimet e fundit që nuk kanë prodhuar zhvillim pozitiv në vend. Prandaj, duhet të ndërrohet qasja në raport me qeverisjen dhe të krijohet një qeverisje që garanton zhvillim dhe mirëqenie për qytetarët e vendit”, ka thënë Rukiqi për

“Ekonomia Online”.

Rukiqi ka theksuar se presin një hyrje të rreth 200 milionë eurove në ekonomi, duke shtuar se në tri vitet e ardhshme duhet të ketë veprime shtesë të cilat mund ta lehtësojë jetën e bizneseve. “Edhe masat në raport me qeverinë dhe puna e bizneseve në kohën e mbetur të vitit duhet të mundësojë që

ato mjete të shpenzohen në Kosovë. Ne presim një hyrje rreth 200 milionë euro në ekonomi. Rimëkëmbja nuk lidhet vetëm me vitin 2021. Duhet edhe veprime shtesë edhe në tre vjetët e ardhshëm në mënyrë që të ketë një ndikim që të lehtësohet jeta e bizneseve dhe të ruhen vendet e punës”, ka përfunduar Rukiqi.

Grabiten dy institucione financiare në Prishtinë



Prishtinë, 20 dhjetor - Policia e Kosovës ka konfirmuar të shtunën se kanë ndodhur dy grabitje në institucione financiare për transfere ndërkombëtare të parave në Prishtinë. Zëdhënësi i Policisë së Kosovës

në rajonin e Prishtinës, Agron Borovci, ka bërë me dije se rasti i parë ka ndodhur në orën 10:30 në filialin e një institucioni financiar në kryqëzimin e rrugëve “Edmond Hoxha” dhe “Hajrullah Abdullahu” në Prishtinë. “Bazuar në

informacionet e para dyshohet që grabitja të jetë kryer nga një person i cili, po ashtu, dyshohet të ketë qenë i armatosur”, ka thënë Borovci.

Grabitja e dytë ka ndodhur në orën 10:40 në një institucion financiar për transfere parash

në rrugën “Bill Clinton”. Policia thotë se dyshohet se kjo grabitje të jetë kryer nga një person.

Për të dy rastet, forcat e rendit kanë nisur hetimet.

Të premten, më 18 dhjetor, një pjesëtar i Policisë së Kosovës u

plagos me armë zjarri nga disa persona që po tentonin të grabisnin para nga një bankomat në Prishtinë. Rasti kishte ndodhur në orët e hershme të mëngjesit të së premtes në një qendër tregtare në lagjen Veternik në Prishtinë.

Kompanitë që nuk raportuan humbje në pandemi

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kompania "Frutex" nga Suheraka dhe "S//Sprint" nga Podujeva, me gjithë vështirësitë për operim gjatë periudhës së pandemisë, kur shumë biznese kanë raportuar humbje financiare, nuk kanë pasur rënie të qarkullimit dhe prodhimit krahasuar me vitin e kaluar. Pronarët e këtyre kompanive pohojnë se me vështirësi dhe me angazhim të punëtorëve kanë arritur të rritet sasia e prodhimit, por jo sipas planifikimeve të bëra. Shaqir Palushi është pronar i kompanisë "Frutex" nga Suhareka, e cila merret me prodhimin e pijeve joalkoolike dhe energjike. Ai nuk e mohon faktin se masat emergjente të vendosura që prej 13 marsit, për ta parandaluar përhapjen e Covid-19, kanë sjellë vështirësi në operim, megjithatë tregon se ka arritur ta përmbyllë vitin me rezultate pozitive.

Palushi: Gjatë këtij viti kemi siguruar tregje të reja ndërkombëtare

Palushi tregon se gjatë këtij viti, përveç tregut në Ballkan, ka

arritur që produktet e "Frutex"-it, sidomos "Golden Eagle", pije joalkoolike, të eksportohen për herë të parë edhe në tregjet e tri shteteve ndërkombëtare. "Përveçse janë rritur numrat në tregjet aktuale në të cilat kemi qenë, kemi shtuar disa vende, ku për herë të parë kemi filluar të eksportojmë në Finlandë, Luksemburg dhe Afrikë, përkatësisht në Kongo", thotë Palushi për "Radion Evropa e Lirë".

Përveç këtyre, në tregjet aktuale ndërkombëtare, ku "Frutex"-i është i pranishëm me produktet e tij, Palushi thotë se është rritur dukshëm shitja e produkteve "Made in Kosova". "Në Gjermani dhe Zvicër kemi shitur nga dy milionë produkte, kurse në tregun e Suedisë, Anglisë dhe të Italisë nga një milion produkte, ndërsa rritje të shitjeve ka pasur në Emiratet e Bashkuara Arabe", thekson ai.

Në kompaninë "Frutex" punojnë rreth 180 punëtorë, kurse 15 punëtorë të rinj janë punësuar gjatë këtij viti, thotë Palushi, duke shtuar se nga fillimi i vitit 2020 për të punësuarit ka rregulluar sigurimin shëndetësor. "Jemi shumë të kënaqur me punën e punëtorëve

sepse vlerësojmë se punëtorët janë asemi më i vlefshëm i kompanisë. Ne mundohemi që edhe pagesat e punëtorëve të jenë të mira", thotë ai.

Sopa: Kemi mbuluar tregun vendor

Kompania "S//Sprint" e cila merret me prodhimin e veshjeve sportive, e që gjendet në Komunën e Podujevës, që dy vjet ka arritur që produktet t'i eksportojë në disa vende të Ballkanit Perëndimor, por edhe në Evropë, përkatësisht në Zvicër, Gjermani dhe Francë. Pronari i kësaj kompanie, Sami Sopa, tregon se gjatë këtij viti nuk ka pasur rritje të shitjes së prodhimeve në këto shtete, por në tregun e Kosovës, shprehet ai, ka pasur rritje të konsiderueshme, çfarë ka bërë që edhe ky vit të mos shënohet me humbje, por me rezultate pozitive në qarkullim. "Shpresojmë se së shpejti do ta fillojmë eksportin në sasi më të mëdha në këto shtete. Fillimisht në tregun e Kosovës ka pasur hezitime, por tashmë jemi jashtëzakonisht të kënaqur. Produktet janë shumë

kualitative dhe kjo ka ndikuar në mbulimin e tregut të Kosovës me produkte të "S//Sprint", por edhe popullata është e kënaqur", tha ai.

Sopa tregon se për ta mbajtur tregun dhe kërkesat për produkte, disa herë kanë punuar edhe përtej orarit. "Gjatë kohës së pandemisë është kërkuar angazhim më i madh, punë më shumë edhe jashtë kohës së rregullt të punës", thotë ai. Ndryshe nga "S//Sprint", kompania "Frutex" ka pasur një rënie të vogël gjatë këtij viti në tregun e Kosovës. Shaqir Palushi thotë se kjo ka ndodhur për shkak të ndërprerjes së punës së sektorit të gastronomisë për dy muaj dhe më pas punës së tyre me orar të kufizuar. "Diferenca e uljes së shitjes vjen nga sektori i gastronomisë, kurse rritje ka pasur në zinxhirin e marketeve", tregon ai.

Edhe Sami Sopa thekson se pa angazhimin dhe vullnetin e punëtorëve kompania nuk do të arrinte që produktet të jenë cilësore. Kjo kompani numëron 100 punëtorë aq sa ka pasur edhe para pandemisë. "Nuk ka humbje të vendeve të punës. E kemi numrin e njëjtë të punëtorëve sikurse vitin e

kaluar, sepse ne i aftësojmë ata për punë. Falë angazhimit të tyre ne kemi punuar edhe jashtë orarit të punës në mënyrë që t'i evitojmë pasojat e pandemisë. Kemi arritur rezultate. Pra, ky rezultat nuk është i yni, por i punëtorëve tanë", thotë Sopa. Pavarësisht prej këtyre kompanive, biznese të shumta në Kosovë kanë raportuar humbje të mëdha për shkak të pandemisë. Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës, humbjet e bizneseve në Kosovë konsiderohen të jenë mbi një miliard euro.

Kuvendi i Kosovës më 4 dhjetor ka miratuar Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike me qëllim që t'i ndihmojë bizneset që kanë pasur vështirësi financiare për shkak të pandemisë. Përveç disa lehtësirave tatimore dhe mundësisë së garantimit të normës së interesit për kredi nga bizneset, në bazë të ligjit janë ndarë 200 milionë euro si subvencion për kompanitë private. Por, autoritetet kompetente ende nuk kanë dhënë informacione për procedurat dhe kushtet e ndarjes së këtyre mjeteve që pritet të realizohen vitin tjetër.



Krasniqi: Pandemia Covid-19 pati ndikim të madh në biznese dhe ekonomi



PRISHTINË, 20 DHJETOR - Situatë e vështirë për ekonominë dhe bizneset si pasojë e pandemisë Covid-19, por edhe goditje që po rëndon jetën e qytetarëve në vend. Kështu ka thënë ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, duke theksuar se pandemia te bizneset dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë ka pasur ndikim mjaft të madh.

Ndonëse ende shteti nuk ka shifra zyrtare për numrin e atyre qytetarëve që kanë humbur vendet e punës për shkak të pandemisë, ministri Krasniqi pohon se pandemia ka ndikuar në uljen e punësimit por, sipas tij, nuk janë 30 mijë persona ashtu siç po raportohet nga sindikatat dhe komuniteti i biznesit. Ai pretendon se kjo

shifër është më e ulët për ata që humbën punën në pandemi. Veç kësaj, Krasniqi ka thënë se rënia e këmbimeve tregtare në fillim të pandemisë ka qenë 100 për qind, ndërsa në pjesën e dytë 20 për qind.

Krasniqi ka thënë se MTI-ja përmes Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike do të ndaj 10.5 milionë euro për bizneset.

Ndërprerjet e shpeshta të rrymës dhe ujit po u sjellin problemeve qytetarëve të Malishevës

MALISHEVË, 19 DHJETOR (ER) - Ditëve e fundit Komuna e Malishevës është duke u përballur me ndërprerje të shumta të energjisë elektrike, në të njëjtën kohë edhe me ndërprerje të ujit për pije, kryesisht në qytet. Të gjitha këto janë duke sjellë probleme të mëdha për banorët. Energjia elektrike është e domosdoshme për të gjitha amvisëritë dhe për të gjitha bizneset. Gjithashtu, edhe

ndërprerjet e ujit janë duke ndikuar në amvisëri dhe biznese, po ashtu edhe në komunikacion për shkak të rrjedhës së ujit në rrugë dhe pengesat që po shkaktohet gjatë riparimeve të gypave. Komuna e Malishevës ka kërkuar nga KEDS-i dhe nga Hidroregjioni Jugor përmirësimin e shërbimeve të tyre në raport me qytetarët, sidomos në këtë periudhë kur vijnë për pushime edhe mërgimtarët.



Arrestohet një person i dyshuar për vjedhje të tri veturave



PEJË, 20 DHJETOR (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë ka njoftuar se më 18 dhjetor në Stacionin Policor në Pejë është paraqitur një rast i vjedhjes së veturës. Vetura e vjedhur e tipit "Shkoda - Fabia" ishte e parkuar në rrugën "Mbretëresha Teutë" në Pejë

dhe në pronësi të një biznesi. "Më 19. 12. 2020 rreth orës 6:30 e njëjta veturë është ndaluar nga patrulla policore e Stacionit Policor Malishevë dhe, pas verifikimeve të nevojshme, ka rezultuar veturë e vjedhur një natë më herët në Pejë. V.L., i lindur më 02.07.1986, i dyshimtë për

vjedhjen e veturës, është arrestuar dhe me urdhër të prokurorit i është caktuar masa e ndalimit prej 48 orëve, ndërsa vetura i është kthyer pronarit", ka njoftuar policia. Sipas këtij njoftimi, ky person ka qenë i dyshimtë edhe për dy vjedhje të tjera të veturave.

Ferizajt pritet t'i shtohet edhe një nënkalim i ri

FERIZAJ, 20 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se është duke përfunduar projekti për ndërtimin e nënkalimit të "Plus Marketi" në këtë komunë. Ai ka thënë se me projekte të tilla është duke ndryshuar Ferizaj. "Një tjetër vepër madhore infrastrukturore ka marrë formë. Nënkalimi të 'Plus Marketi' është drejt përfundimit. Nga një kënd në tjetrin, Ferizaj po ndryshon. Tablosë së investimeve të mëdha për transformimin e

infrastrukturës rrugore iu shtua edhe segmenti i sapoasfaltuar që pësoi ndryshim tërësor në degëzimin e rrugëve 'Liman Reka' dhe 'Rizah Matoshi', pjesë e sipërme e projektit të nënkalimit të paraparë me 'Bashkimin e Qytetit' të 'Plus Marketi'. Së shpejti do të përfundojnë edhe punimet në nënkalim, për t'u dhënë banorëve të kësaj pjese një infrastrukturë moderne, ndërkaq qytetit një vepër madhështore të infrastrukturës rrugore", ka thënë Aliu.



Komuna e Vushtrrisë ndan 63 krerë lopë për persona me asistencë sociale

VUSHTRRI, 20 DHJETOR (ER) - Komuna e Vushtrrisë, në bashkëpunim me Shoqatën "Islamic Relief Kosova", ka bërë shpërndarjen e 63 krerë të lopëve qumështore për personat me asistencë sociale. Drejtori i Bujqësisë i kësaj komune, Miran Halili, ka bërë me dije se vlera e këtij projekti është 400 mijë euro. "Ky projekt është për persona me asistencë sociale. Është projekt i përbashkët në mes të Komunës së Vushtrrisë, Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Pylltari, dhe Shoqatës 'Islamic Relief Kosova'. Vlera e këtij projekti është mbi 400 mijë euro. Me këtë rast, falënderoj 'Islamic Relief Kosova' që na ka mbështetur në këtë projekt për personat me asistencë sociale,


të cilëve mendojmë se do t'ua lehtësojmë sadopak jetën", ka thënë Halili.

Ndërsa përfituesi i kësaj ndihme, Remzi Ademi, ka falënderuar kryetarin Xhafer Tahiri dhe Shoqatën "Islamic Relief Kosova" për dhurimin e këtyre lopëve. "Kjo ndihmë është e mirëseardhur. Falënderojmë kryetarin e komunës për këtë projekt dhe shoqatën islamike që na ka ndihmuar me këto lopë", ka thënë Ademi.

Edhe përfituesja Fahrie Begu ka falënderuar donatorët, ndërsa është shprehur e lumtur që është përfituese e kësaj ndihme. Kusht për përfitimin e një lope ka qenë që përfituesi të jetë në asistencë sociale si dhe ta ketë stallën dhe ushqim për bagëti të paktën për një vit.



Pse Murat Jashari, nipi i bacës Adem Jashari, duhet të jetë president i ri Kosovës



Nga Bedri ISLAMI

Në Kosovë është një gjendje politike tejet e veçantë: pas dorëheqjes së detyrueshme të ish-presidentit Hashim Thaçi, për shkak që dihen, vendi është me ushtruesen e detyrës, e cila është edhe kryetare e Kuvendit. Janë dy mundësi: zgjedhja e një presidenti të ri përmes kompromiseve jo të lehta, ose zgjedhjet e reja parlamentare.

Nga katër parti kryesore shqiptare në Kosovë, tri prej tyre aspirojnë të kenë për vete postin presidencial: AAK-ja e synon këtë për liderin e saj, Ramush Haradinaj, dhe ai vetë e ka shpallur haptas synimin e tij; PDK-ja, së cilës i mungon kryetari i saj, Kadri Veseli, e quan të domosdoshme që posti presidencial të jetë për një zgjedhje të saj, duke mohuar përkrahjen nga Haradinajt; ndërkohë LDK-ja, që ka postin kryeministrot, pasi ka humbur vendin e kryetarit të Kuvendit, me ndarjen e saj nga zonja Osmani, e quan normale të ketë edhe vendin e presidentit. Lëvizja Vetëvendosje nuk do asnjëherë të zgjidhje, ajo kërkon zgjedhje të reja, si rruga e vetme për t'ju qasur edhe një herë pushtetit ekzekutiv e jo vetëm kaq. Pas fitores së drejtpërdrejtë të saj në zgjedhjet komunale në Podujevë, bastioni i dikurshëm i LDK-së, oreksi është rritur.

Këto ditë, lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, bëri një propozim që, dikur ka qenë edhe ide e Lëvizjes Vetëvendosje, pikërisht kur ajo qeveriste dhe kishte shpallur haptas synimin për rrëzimin e Thaçit. Fatmir Limaj deklaroi se forca e tij politike, e cila nuk ka asnjë ambicje për president do të mbështeste me forcë një figurë gjithëbashkuere shqiptare, që do të bënte të mundur unifikimin e faktorit shqiptar, të ishte realisht mbi partitë politike dhe të gëzonte besimin sa më të gjerë të mundshëm të një opinionit publik të tronditur rëndë nga shumë arsye të keqpërdorimit të pushtetit dhe nga Gjykata Speciale.

Ai propozoi që në këtë post, të presidentit të Kosovës, të

propozohet dhe të bashkoheshin për Murat Jasharin, nipin e Adem e Hamzë Jasharit, djalin më të madh të familjes së njohur Jashari, rreth së cilës janë mbledhur të gjithë shqiptarët.

“Unë mendoj, tha Limaj, se presidenti i Kosovës duhet të vijë sipas një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të forcave politike, gjë që është e vështirë të ketë një konsensus, prandaj mendoj se duhet të përcaktohem për një figurë gjithëpërfshirëse. Është i vështirë konsensusi, por, kur është fjala për familjen Jashari, për Murat Jasharin, kjo është diçka tjetër, ajo është përtej politikës. Është i vetmi institucion që na bashkon. Ndoshta tashti është momenti për diçka tjetër. Murat Jashari nuk është parti politike, mos e krahasoni atë me përfaqësuesin e LDK-së, PDK-së, Nismës...”

A është me vend një propozim i tillë dhe a duhet mbështetur nga forcat politike në Kosovë. Ne mendojmë se, po. Duhet mbështetur. Duhet bashkuar rreth një figure unitare, që përmbledh në vete, njëherësh, shumë nga ata cilësi të domosdoshme, sidomos në këtë periudhë të zhvillimit të ngjarjeve.

Për secilën figurë politike që do të aspironte në këtë post të lartë, më të lartin në hierarkinë shtetërore të Kosovës, do të duheshin disa garanci të domosdoshme, të

patjetërsueshme, të cilat do të garantonin që presidenca të jetë vërtet shembëlltyra e unitetit, qendër e besimit dhe e besueshme në shkallën më të lartë të mundshme.

Asnjë figurë politike në Kosovë, qoftë nga opozita apo nga pushteti, nuk e gëzon këtë status të lartë. Asnjëri nuk është aktualisht personalitet i padiskutueshëm politik, rreth të cilit të mund të besohet se do të jetë vërtetë simbol i unitetit apo përfaqësuesi i popullit. Cilido që do të zgjidhet, sidomos në këtë situatë të vështirë politike, kur janë shtruar mjaft probleme të vështira, që kanë të bëjnë me të ardhmen e shtetit të Kosovës dhe zhvillimet e saj nuk do të jetë i pa =paragjykuar dhe i baras larguar nga forcat politike.

Ndaj është e domosdoshme të jetë një figurë politike mbi palët, që nuk përfaqëson një forcë politike, qoftë kjo edhe më e votuara tani për tani apo një koalicion qeverisës.

Në botën intelektuale, disi jashtë politikës, edhe mund të ketë një figurë të tillë përbashkuere, por gjykimi mbi çdo hap të tij do të jetë i gjykuar. Ndryshe ndodh me figurën e Murat Jasharit, i cili është doktor i shkencave juridike, asistent profesor në Fakultetin juridik, që do të thotë se ka njohje edhe të zhvillimeve në fushën e ligjeve dhe të jurispendencës.

Nga ana tjetër janë disa

përparësi absolute. Që lidhen me gjenezën e tij. Me qëndrimet e mbajtura nga familja e tij, jo vetëm gjatë luftës, por edhe pas saj, e shkëputur nga interesa politike të çastit, përkatësi politike apo anësi. Ata, si familje, përgjithësisht, kanë arritur, megjithë joshjet, premtimet e vështirësitë, të qëndrojnë mbi palët, të jenë derë e hapur për të gjithë dhe të mos bëhen palë me askënd.

Familja Jashari ka një simbol të pallogaritshëm, ku janë përlurur dhe kanë besuar me përkushtim të gjithë shqiptarët. Pavarësisht bindjeve të tyre, vendeve ku kanë lindur dhe trojeve ku banojnë. Adem Jashari, themeluesi dhe komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, që në ditët e para të organizimit të radhëve të luftës ka qenë njeriu përbashkuar. Rreth tij janë mbledhur pa asnjë dallim shqiptarët nga të gjitha trojet dhe besimi tek ai, atdhedashuria, përkushtimi dhe qëndresa e tij dhe e Familjes Jashari, kanë qenë të pashoqe.

Nëse partitë politike shqiptare në Kosovë do të përcaktoheshin për të zgjedhur një president përbashkuar, si Murat Jashari, kjo do të ishte edhe një mesazh ndaj të gjithë atyre që, me fillimin e veprimit të Gjykatës Speciale mund të mendojnë se ajo periudhë do të nëpërkëmbet, se asgjë nuk është harruar dhe se e përbashkta e partive politike

në Kosovë është nderimi i vlerave.

Tani dy gjëra janë thelbësore: Së pari, prononcimi i zotit Limaj në media dhe dakordësimi i tij për të pasur president të Kosovës një figurë të njohur politike e atdhetare si Murat Jashari, nuk është i mjaftueshëm.

Nga ideja duhet kaluar në një nismë zyrtare të forcës politike që Ai përfaqëson, duke dërguar në Parlamentin e Kosovës emrin e Murat Jasharit si kandidat për postin presidencial.

Vetëm zyrtarizimi i kësaj ideje do të saktësojë edhe seriozitetin e saj.

Së dyti, Kuvendi i Kosovës duhet të bëjë votim të hapur, jo me votim të fshehtë, për miratimin e Murat Jasharit në postin e të parit të shtetit të Kosovës.

Vota e fshehtë mund të jetë e vlefshme në të gjitha rastet e tjera, por jo kësaj here. Është momenti kur gjërat të bëhen haptas, edhe jashtë procedurave të zakonshme, sepse vetë gjendja nuk është e tillë.

Përbetimet për nderim dhe besnikëri ndaj vlerave të luftës çlirimtare do të jenë të dallueshme ashtu si do të përshfaqen edhe kundërshtitë. Megjithëse do të jetë e vështirë të kalojë një propozim i tillë, kjo është e vetmja rrugë për të pasur një figurë gjithëpërfshirëse në kreun e shtetit të Kosovës.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Prishtina, paqe me Dritën

Sezoni vjeshtor është mbyllur me dy ndeshjet e mbetura nga xhirot e mëhershme në mes të Prishtinës dhe Dritës dhe Ballkanit dhe Gjilanit. Prishtina luajti baras me skuadrën lidere, Dritën (1-1), ndërsa Gjilani e deklasoi Ballkanin 0-4



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Derbi në mes të Prishtinës dhe Dritës në elitën e futbollit të Kosovës përfundoi 1-1. Ndeshja e zhvilluar të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" ishte mjaft interesante dhe me disa raste shënimi, kurse dy golat janë shënuar nga penalltia. Trajneri i Prishtinës, Zekirija Ramadani, ka thënë se fitorja në derbi është dashur t'i takojë skuadrës kryeqytetase. "Gjithmonë kur nuk arrijmë fitoren, fajin e shohim te vetja. Kur nuk realizojn, atëherë është normale të ndëshkohesh. Kishim kontrollin e topit dhe rezultatin, por në pjesën e dytë është dashur më mirë ta menaxhojmë lojën. Drita e mori atë për çka kishte ardhur. Përgëzoj futbollistët e Prishtinës për angazhimin, ndonëse është dashur ta fitojmë këtë ndeshje ku patëm shumë raste të humbura", ka thënë pas ndeshjes Ramadani. Prishtina ishte e para që rrezikoi portën e kundërshtarit në minutën e shtatë, por gjuajtjen e Otto John e ndali portieri Rexhepi. Shtatë minuta më vonë, Rexha provon të godasë, por gjuajtja e tij bllokohet nga Tun Bardhoku. Në minutën e 17 Otto John del edhe një herë në skenë, por edhe kësaj radhe shpëtimtar i mysafirëve ishte portieri. Një rast të mirë për vendësit pati edhe Dellova, por

gjuajtja e tij përfundoi jashtë portës. Në minutën e 38 Endrit Krasniqi ndalet nga Arago dhe gjyqtari kryesor akordoi penallti. Nga pika e bardhë i pagabueshëm ishte Besnik Krasniqi që realizoi për 1-0. Otto John pati edhe një rast të mirë shënimi në minutën e 78, por edhe kësaj radhe në vend ishte Rexhepi. Shtatë minuta pa përfunduar ndeshja, Dellova luajti me dorë në zonën e rreptësisë dhe gjyqtari kryesor për herë të dytë në ndeshje akordon penallti, kësaj radhe për skuadrën mysafire. Nga pika e bardhë i pagabueshëm ishte Fidan Gërbeshi që realizoi për 1-1. Në minutat shtesë Blakçori përjashtohet nga ndeshja për shkak të dy kartonëve të verdhë. Ndeshja përfundoi me rezultat 1-1. Pas ndeshjes, trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu, ka deklaruar: "Në përgjithësi mendoj se ishte një ndeshje e hapur, një derbi i vërtetë. Të dyja ekipet kërkuan fitoren. Prishtina kishte raste më të pastra, por portieri na mbajti në lojë. Pjesa e dytë na takoi neve dhe erdhëm edhe te goli. Dua t'i falënderoj futbollistët për një sezon shumë të mirë, përkundër orarit të ngjeshur. Kemi bërë një gjysmësezon të jashtëzakonshëm dhe kemi pasur paraqitje shumë të mira në përgjithësi. Nuk diskutohet se jam i kënaqur me pozitën e parë, duke pasur parasysh kohën e pandemisë dhe situatën që ka mbretëruar. Sigurisht se do ta mbajmë ekipin

aktual, por mbetet të shihet nëse do të ketë ndonjë ndryshim". Pas kësaj ndeshje, Prishtina është e treta në tabelë me 32 pikë, ndërsa Drita zë vendin e parë me 41 pikë. Ndërsa të shtunën në Suharekë është zhvilluar ndeshja e mbetur e javës së 12-të në Superligë ndërmjet Ballkanit dhe Gjilanit. Fitores në këtë takim iu gëzua skuadra mysafire Gjilani (0-4). Futbollisti Ardit Hila ishte lojtari kryesor, pasi në këtë ndeshje realizoi tre gola për skuadrën e drejtuar nga Bylbyl Sokoli, kurse me një gol kontribuoi Darko Nikaq. Pas kësaj fitoreje, Gjilani ka 29 pikë dhe zë pozitën e katërt në elitë, derisa Ballkani mbetet në pozitën e dytë, me 38 pikë.

| SUPERLIGA | | |
|--------------------|----|------|
| Prishtina - Drita | | 1-1 |
| Ballkani - Gjilani | | 0-4 |
| Tabela | | |
| | | Pikë |
| 1. Drita | 18 | 41 |
| 2. Ballkani | 18 | 38 |
| 3. Prishtina | 18 | 32 |
| 4. Gjilani | 18 | 29 |
| 5. Feronikeli | 18 | 23 |
| 6. Arbëria | 18 | 21 |
| 7. Trepça '89 | 18 | 21 |
| 8. Llapi | 18 | 20 |
| 9. Drenica | 18 | 19 |
| 10. Besa | 18 | 6 |

SHKURT

Zeqiri debuton te Brightonit

Sulmuesi Andi Zeqiri ka debutuar në Premierë Ligë. Zeqiri luajti 18 minutat e fundit të ndeshjes që Brightonit barazoi 1:1 në shtëpi ndaj Sheffield Unitedit. Ky duel u luajt të dielën në kuadër të xhiros së 14-t të elitës së futbollit anglez. Brightonit zë vendin e 16 me 12 pikë. Sulmuesi 21-vjeçar te Brightonit u transferua në tetor të këtij viti nga skuadra zvicerane Lausanne.

Përforcohet KB Peja

Klubi i Basketbollit Peja ka njoftuar për përforcimin e radhës. KB Peja ka bërë marrëveshje me basketbollistin amerikan Brandon Walters. Ai luan në pozitën qendër, ndërsa KB Peja deklaroi se Walters ka shkëlqyer sezonin e kaluar te Kataja në Superligën e Finlandës, me 16.8 pikë dhe 5.8 kërcime.

Atletico merr vendim për Simeonen

Atletico Madridi do ta "blindojë" Diego Simeonen. Sipas "Marca", përparësia për klubin madrilen është ta rinovojë kontratën me trajnerin argjentinas që skadon në vitin 2022. Natalia Simeone, motra dhe menaxherja e Cholos, do të merret me rinovimin. Simeone ka marrë drejtimin e Atletico në vitin 2011.

Feronikeli transferon Kojaseviqin

Skuadra e Feronikelit ka nënshkruar kontratë me malazezin Damir Kojaseviq. Klubi nga Drenasi ka njoftuar se Kojaseviq është përforcimi më i ri i skuadrës i cili luan në dy anët e krahut. Malazezi Damir Kojaseviq dhe klubi i Feronikelit kanë arritur marrëveshje. "Kojaseviq me Përfaqësuesen e Malit të Zi ka zhvilluar me shumë se 10 ndeshje, ndërsa karrierën e zhvilloi edhe në Poloni te ekipi Jagiellona, në Kazakistan te FC Astana dhe në Maqedoni ishte te ekipi i Vardarit, ndërsa te Feronikeli erdhi nga klubi i Sutjeskës së Malit të Zi", thuhet në njoftimin e "Niklit".

"Marca" ia kushton një artikull Përfaqësueses së Kosovës

Gazeta e njohur spanjolle "Marca" i ka kushtuar një vëmendje të madhe Përfaqësueses së Kosovës në futboll me të cilën do të ndeshet Spanja në kuadër të kualifikimeve për kampionatin Botëror. Gazeta përmend faktin se Kosova ende nuk mund të luajë me futbollistë që kanë lindur pas vitit 2008 kur edhe Kosova fitoi pavarësinë. Ata tregojnë historinë se si futbollistët Rashica, Muriqi, Ujkani, Berisha ishin shpërngulur nga Kosova për në vendet e Evropës për shkak të luftës gjatë vitit 1999. Gjithashtu në këtë artikull përmendet edhe oferta që Kosova ia kishte bërë Adnan Januzajt. Gjashtë vjet më vonë, pas pranimit të Kosovës në FIFA dhe UEFA, "dardanët" po përgatiten të përballen me Spanjën në një grup në të cilin vetëm Suedia e njuh vendin e saj, thuhet në shkrimin e gazetës "Marca".

Zbulohet letra e Maradonas: Ja çfarë duhet të bëni me trupin tim pas vdekjes

BUENOS AIRES, 20 DHJETOR - Një letër e nënshkruar nga Diego Armando Maradona më 13 tetor dëshmon se legjenda e Argjentinës dhe Napolit kishte kërkuar që trupi i tij të balsamohej dhe të ekspozohej në një muze.

Maradona e kishte shprehur këtë amanet në një letër që ia kishte dërguar avokatit të vet, Matias Morla. Letra e tij është publikuar nga tabloidi britanik "The Sun". "Pas një analize të thellë, dua ta shpreh dëshirën që pas

vdekjes sime, trupi im të balsamohet dhe të ekspozohet në muze, i rrethuar nga trofetë e mi", shkruhet në letër. Maradona vdiq më 25 nëntor nga një sulm në zemër. Mario Baudry, avokati i partneres së fundit

të Maradonës, Veronica Ojeda, ka deklaruar: "Plani është ta krijojmë një mauzoleo diku që tifozët ta vizitojnë. Kjo është diçka për të cilën kishte biseduar edhe Maradona me vëllezërit e vet".



Ponte Prizreni triumfon ndaj Vëllaznimit

PRIZREN, 20 DHJETOR - Ponte Prizreni ka shënuar fitore ndaj Vëllaznimit me shifrat 98:82 (21:14, 20:26, 31:12, 26:30), në kuadër të javës së nëntë të Prince Caffè Superligës. Skuadra prizrenase e nisi ndeshjen më mirë, duke fituar çerekun e parë 21:14. Megjithatë, në periudhën e dytë, kundërpërgjigjet skuadra mysafire 20:26, duke shkuar në pushim me shifrat 41:40. Perioda e tretë ishte vendimtare në këtë ndeshje. Ponte tregon fuqinë duke fituar 31:12, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 72:52. 10 minutat ishte vetëm formale (20:26) dhe Ponte Prizreni fitoi me rezultat 98:82. Të Ponte Prizren u dalluan Xavier Cannefax me 30 pikë, Arti Hajdari me 24 dhe Ty Nichols me 13 pikë e 11 asistime, kurse te Vëllaznimit më i miri ishte Devonte Jackson me 20 pikë e nëntë kërcime. Ponte Prizreni ka gjashtë fitore dhe tri humbje, kurse Vëllaznimit tri fitore dhe gjashtë humbje. KB Rahoveci ka fituar derbin ndaj Pejës me rezultat 86:77 (25:16, 27:15,



10:16, 24:30), në kuadër të javës së nëntë të Prince Caffè Superligës. Vendasit e kontrolluan lojën nga fillimi deri në fund, duke mos e rrezikuar fitoren në këtë përballje. Vreshtarët e nisin ndeshjen më mirë, duke e fituar çerekun e parë 25:16, derisa me lojë të mirë vazhduan edhe në periudhën e dytë, që e fituan 27:15, duke shkuar në pushimin mes pjesëve 52:31. Pejanët ishin më të mirë në pjesën e dytë. Ata

fituan periudhën e tretë, 10:16 dhe atë të fundit 24:30, megjithatë, Rahoveci fitoi në fund me rezultat 86:77. Te Rahoveci u dalluan Isaiah Traylor me 30 pikë, shtatë kërcime e gjashtë asistime dhe Marvin Jones me 24 pikë, kurse te Peja më të dalluarit ishin Drilon Hajrizi me 29 pikë e 17 kërcime dhe Robert Cartwright me 18 pikë. Tashmë të dy skuadrat kanë nga gjashtë fitore dhe dy humbje.

Prishtina dhe Penza në gjysmëfinale

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Janë zhvilluar ndeshjet në rrethin e parë të Kupës së Kosovës në basketboll në konkurrencën e femrave. Kosovahome Prishtina pa shumë vështirësi ka mundur Trepçën 71:38 (18:10, 20:8, 17:12, 16:8). Vashat prishtinase dominuan nga fillimi deri në fund, duke arritur fitore të merituar.

Te Kosovahome Prishtina u dalluan Enisa Kamerolli me 12 pikë, tetë kërcime e nëntë asistime, Besjana Martinaj me 19 pikë dhe Era Shatri me 13 pikë, derisa te Trepça më e mira ishte Ervala Shabani me 10 pikë, tetë kërcime e gjashtë asistime.

Fitore bindëse realizoi edhe Penza, që mundi Kastriotin 85:51 (22:13, 18:15, 26:13, 19:10). Te skuadra pejane u dalluan Vanesa Bojku me 18 pikë e gjashtë kërcime, Tringa Ukaj me 17 pikë, shtatë kërcime e tetë asistime dhe Valbona Bytyqi me 12 pikë, 13 kërcime e 10 asistime. Kosovahome



Prishtina në gjysmëfinale të Vëllaznimit, kurse Penza me Kupës do të ndeshet me Bashkimin.

SHKURT

Presidenti i Barcelonës: Koeman po bën punë të mirë

Presidenti i përkohshëm i Barcelonës, Carles Tusquets, i ka dalë në mbrojtje trajnerit Ronaldo Koeman pas barazimit të katalonasve 2-2 me Valencian të shtunën në La Liga. Tifozët e Barcelonës kanë nisur t'i shprehin pakënaqësitë e tyre me punën dhe metodat e trajnerit holandez i cili mori drejtimin e skuadrës në gusht. Por Tusquets beson se Koeman po bën punë të mirë me skuadrën. "Nuk do ta fajësoj askënd. Koeman po bën mirë dhe e ka përkrahjen time. Kam ngrënë disa herë me Koemanin dhe ai më duket optimistik", ka thënë Tusquets.

Salah: Një ditë dua të luaj për Barçën ose Realin

Sulmuesi egjiptian Mohamed Salah po luan sezonin e tij të katërt me fanellën e Liverpoolit, klub në të cilin ka fituar shumë trofe gjatë kësaj periudhe, si Ligën e Kampionëve dhe, së fundi, titullin kampion në Premierë Ligë. Ndonëse ka ende edhe tre vjet kontratë me "The Reds", 28-vjeçari ka pranuar se një ditë do të preferonte ta vishte fanellën e Realit të Madridit apo të Barcelonës, të cilat i ka evidentuar si skuadrat më të mira. "Nuk i dihet çfarë do të ndodhë në të ardhmen, por Real Madridi dhe Barcelona janë dy nga klubet më të mira në botë dhe një ditë do të më pëlqente të luaja për to. Megjithatë, për momentin jam i lumtur te Liverpooli", u shpreh egjiptiani. Deklaratat e Salah vijnë vetëm disa ditë pasi mediat spanjolle kanë aluduar për një shkëmbim të mundshëm mes tij dhe Philipp Coutinhos, me brazilianin që nuk po përshtatet te Barcelona dhe mezi pret rikthimin në "Anfield Road", aty ku ka kaluar vitet më të bukura të karrierës.

Messi i barazoi rekordin historik, Pele: Dashuri si të tonat janë të rralla

Leo Messi realizoi në barazimin kundër Valencias (2-2). Argjentinasi gjeti golin e tij të 643 me Barçën duke barazuar rekordin e Peles. 33-vjeçari ka po aq gola sa Pele të shënuar me një klub dhe me siguri do ta tejkalojë legjendën e Brazilit. Pele në krahun tjetër ka lënë një urim për Messin. "Kur zemra vërshon nga dashuria, është e vështirë ta ndryshosh rrugën tënde. Ashtu si ti, unë e di se si është të duash të veshësh të njëjtën fanellë çdo ditë. Ashtu si ti, unë e di se nuk ka asgjë më të mirë se vendi ku ne ndihemi si në shtëpi", ka shkruar Pele.

Matthaus kritikon Sanen

Ish-futbollisti i njohur gjerman Lothar Matthaus kritikoi lojtarin e Bayern Munchenit, Leroy Sane, i cili ende nuk po arrin ta fitojë vendin e titullarit te kampionët e Evropës. Në një intervistë për "T-Online", ish-kampioni i botës kërkon që Sane të punojë më shumë në prapavijë. Kritikën erdhën teksa ish-futbollisti i Manchester Cityt u hodh në fushë në minutën e 32-të dhe u zëvendësua në pjesën e dytë. "Një lojtar titullar do të duhej ta kalonte Comanin dhe Gnabryn. Diferenca është e madhe. Sane ka qenë i dëmtuar për një kohë të gjatë. Duhet të përshtatet me sistemin e lojës së Bayernit. Ka deficite në lojën mbrojtëse. Kjo është arsyeja se përse Guardiola e la të ikte, sepse Sane nuk punon në mbrojtje ashtu siç duhet. Duhet të mësojë ende. Procesi i përshtatjes ende nuk ka përfunduar për të. Nuk mendoj se presioni ka qenë më pak te Manchester Siti, por Sane duhet të përgatitet që ta hedhë hapin e radhës", ka deklaruar Matthaus.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një veper filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



ISBN 978-9951-780-37-7
9 789951 780377

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



ISBN 978-9951-780-10-0
9 789951 780100

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Komuna e Mitrovicës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës së riciklimit të mbeturinave në Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.01.2021 në ora 10:30 në hapësirat e komunës - në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Mitrovicës në adresën Rr: "Bedri Gjinaj" - Nr.Post: 40000 do të organizohet debat publik nga Komuna e Mitrovicës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës së riciklimit të mbeturinave në Mitrovicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/9662771284?pwd=dXgzVW9BalhS3IKdEVTV1FO NTfVz09>

Meeting ID: 966 277 1284

Passcode: 112233

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Berlin Chemie/A.Menarini Kosovo" L.L.C, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 71067858.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobilave "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihen çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

